



**Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor
Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës**

Vlerësim Preliminar i Llojeve Endemike të Faunës në Kosovë

*Dokument pune për identifikimin dhe vlerësimin paraprak
të llojeve endemike të faunës së Kosovës*



Prishtinë, 2026

Hyrje

Ky raport paraqet një vlerësim preleminar të llojeve endemike të faunës në Kosovë, i bazuar në të dhëna nga literatura shkencore, Libri i Kuq i Faunës, Udhëzimin Administrativ MEA - Nr.12/2020 për Llojet e Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura, publikime relevante akademike si dhe hulumtimeve në terren. Qëllimi i këtij studimi është identifikimi dhe sistematizimi i llojeve endemike me shpërndarje të kufizuar në territorin e Kosovës, duke kontribuar në përmirësimin e njohurive mbi biodiversitetin dhe në mbështetjen e masave të ardhshme të konservimit.

Raporti është realizuar në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, Departamenti i Biologjisë (prof. Halil Ibrahim) dhe synon të shërbejë si bazë për vlerësime të mëtejshme shkencore dhe institucionale.



Potamophylax coronavirus



Drusus dardanicus

1. Vështrim i përgjithshëm

Biodiversiteti i Kosovës karakterizohet nga një pasuri e lartë biologjike, e ndikuar nga pozita gjeografike, relievi i larmishëm dhe kushtet ekologjike të ndryshme. Brenda këtij diversiteti, llojet endemike përbëjnë një komponent veçanërisht të rëndësishëm, pasi ato përfaqësojnë taksa me shpërndarje të kufizuar dhe vlerë të lartë shkencore dhe konservuese.

Studimi i llojeve endemike është thelbësor për kuptimin e evolucionit lokal, strukturës ekologjike dhe përcaktimin e prioriteteve për mbrojtjen e natyrës.

Llojet endemike janë organizma që gjenden vetëm në një zonë të caktuar gjeografike dhe nuk hasen në asnjë pjesë tjetër të botës. Kosova përmban disa lloje endemike të faunës, sidomos insekte ujore dhe merimanga, të cilat janë përshkruar dhe identifikuar në vitet e fundit, duke dëshmuar pasurinë e lartë biologjike të vendit. Këto specie përfaqësojnë një vlerë të rëndësishme natyrore të Kosovës dhe kërkojnë mbrojtje të veçantë për ruajtjen e tyre për brezat e ardhshëm.

2. Objektivat e studimit

Ky raport ka për qëllim:

- Identifikimin e llojeve endemike të faunës në Kosovë;
- Sistematizimin e tyre në formë të tabeluar;
- Vlerësimin e statusit të tyre konservues;
- Krijimin e një baze fillestare për monitorim të mëtejshëm;
- Mbështetjen e politikave të mbrojtjes së biodiversitetit.

3. Metodologjia

Të dhënat e përdorura në këtë raport janë mbledhur përmes rishikimit të literaturës ekzistuese shkencore dhe burimeve zyrtare, duke përfshirë:

- Librin e Kuq të Faunës së Kosovës;
- Udhëzimin Administrativ MEA – Nr.12/2020 për Llojet e Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura;
- Publikime shkencore relevante nga revista akademike;
- Raporte institucionale dhe databaza të biodiversitetit;
- Konsultime dhe bashkëpunim shkencor me prof. Halil Ibrahim.

Metodologjia është e bazuar në analizë desk-work (desk study), të dhëna të reja nga terreni, dhe me përpunim kritik të burimeve ekzistuese.

4. Rezultatet

Bazuar në analizën e burimeve të konsultuara, janë identifikuar lloje endemike të faunës së Kosovës, të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Llojet endemike të Faunës në Kosovës						
Rendi	Familja	Lloji	Lokacioni	Referenca	Kategorizimi sipas IUCN	Kategorizimi sipas librit të kuq
Araneae	Nemesiidae	<i>Brachythele kosovarica</i>	Veriq, Istog, Mitrovicë, Pejë, Prizren	Geci et al., 2025	Nuk është vlerësuar	Nuk është vlerësuar
Araneae	Agelenidae	<i>Eratigena mirusha</i>	Panorc, në Malin Koznik	Geci et al., 2025	Nuk është vlerësuar	Nuk është vlerësuar
Araneae	Dysderidae	<i>Harpactea dardanica</i>	Pyllin e Ahut, PK "Bjeshkët e Nemuna"	Geci et al., 2025	Nuk është vlerësuar	Nuk është vlerësuar
Araneae	Nemesiidae	<i>Nemesia dukagjinica</i>	Veriq, Istog, Mitrovicë, Pejë, Prizren	Geci et al., 2025	Nuk është vlerësuar	Nuk është vlerësuar
Trichoptera	Limnephilidae	<i>Potamophylax coronavirus</i>	PK "Bjeshkët e Nemuna"	Ibrahimi et al., 2021	Nuk është vlerësuar	Nuk është vlerësuar
Trichoptera	Limnephilidae	<i>Potamophylax humoinsapiens</i>	Malet e Sharrit, degë e lumit Lepencë	Ibrahimi et al., 2023	Nuk është vlerësuar	Nuk është vlerësuar
Trichoptera	Limnephilidae	<i>Potamophylax kosovaensis</i>	Degë në lumin Kaçandoll dhe lumin Llap	Ibrahimi et al., 2024	Nuk është vlerësuar	Nuk është vlerësuar
Trichoptera	Rhyacophilidae	<i>Rhyacophila siparantum</i>	Bogë, Malin e Rugovës	Ibrahimi et al., 2021	Nuk është vlerësuar	Nuk është vlerësuar
Trichoptera	Psychomyiidae	<i>Tinodes lumbardhi</i>	Lumbardhi i Deçanit	Ibrahimi et al., 2025	Nuk është vlerësuar	Nuk është vlerësuar
Trichoptera	Limnephilidae	<i>Drusus dardanicus</i>	Përroskë në fshatin Bollosicë	Ibrahimi et al., 2015; 2019	Nuk është vlerësuar	CR
Trichoptera	Limnephilidae	<i>Drusus fortos</i>	Bjeshkët e Nemuna	Olah et al., 2017	Nuk është vlerësuar	Nuk është vlerësuar
Trichoptera	Limnephilidae	<i>Drusus sharrensis</i>	Bjeshkët e Sharrit	Ibrahimi et al., 2016; 2019	Nuk është vlerësuar	CR
Trichoptera	Limnephilidae	<i>Drusus vekon</i>	Bjeshkët e Nemuna	Olah et al., 2017	Nuk është vlerësuar	Nuk është vlerësuar
Trichoptera	Limnephilidae	<i>Limnephilus petri</i>	Lumi Brod, Dragash	Kumanski., 1988; I2017	Nuk është vlerësuar	CR
Coleoptera	Carabidae	<i>Deltomerus (Deltomerus) nopcsai</i>	Koprivnik	Csiki 1940; Gabor Mesaros 2018; Ibrahimi et al., 2019	Nuk është vlerësuar	VU
Coleoptera	Leiodidae	<i>Pavicevicia comottiorum</i>	Rugovë	Perreau 2008; Gabor Mesaros 2018; Ibrahimi et al., 2019	Nuk është vlerësuar	VU
Coleoptera	Leiodidae	<i>Pavicevicia pretneri</i>	Shpella Lazina	Perreau 2008; Gabor Mesaros 2018; Ibrahimi et al., 2019	Nuk është vlerësuar	VU
Littorinimorpha	Bythinellidae	<i>Belgrandiella bumasta</i>	Gryka e Rugovës, afër Pejës	Schutt 1960; Seddon 2011a; Ibrahimi et al., 2019	DD	VU
Littorinimorpha	Bythinellidae	<i>Bythinella istoka</i>	Burimi karstik, afër Malit Mokna	Gloer & Pesic 2014; Zoltan Feher 2018; Ibrahimi et al., 2019	Nuk është vlerësuar	VU
Littorinimorpha	Hydrobiidae	<i>Terranigra kosovica</i>	Nerodime e Epërme, Pridvoricë, Caralevë	Radoman 1978; Radoman 1983; Seddon 2011c; Zoltan Feher 2018; Ibrahim	NT	VU
Stylommatophora	Hygromiidae	<i>Monachoides kosovoensis</i>	çakorr	De Winter and Maassen 1992; Feher 2011b; Zoltan Feher 2018	NT	VU
Littorinimorpha	Hydrobiidae	<i>Plagigeyeria gladilini</i>	Drini i Bardhë, Radavc	Georgiev 2010; Grego et al., 2017; Kuscer 1937; Zoltan Feher 2018	VU	VU
Littorinimorpha	Hydrobiidae	<i>Saxurinator schlickumi</i>	Burimi i Istogut, Pejë, Mitrovicë	Grego et al. 2017; Schutt 1960; Seddon 2011b; Zoltan Feher 2018	DD	NT
Polydesmida	Polydesmidae	<i>Brachydesmus jalzici</i>	Shpella e Dushit, Klinë	Mrsic 1985; 1988; Makarov et al., 2004; Antic et al., 2013; Lucija Seric Jelask	Nuk është vlerësuar	VU
Polydesmida	Polydesmidae	<i>Polydesmus undeviginti</i>	Burimi i Drinit të Bardhë, Shpella e Radavcit	Makarov et al., 2004; Mrsic 1985; Strasser 1971a; Lucija Seric Jelaska 2018	Nuk është vlerësuar	VU
Isopoda	Trichoniscidae	<i>Alpioniscus metohicus</i>	Shpella në Radavc	Curcic & Decu 2008; Pljakic 1971; Schmal - fuss 2003; Lucija Seric Jelaska 2018	Nuk është vlerësuar	VU
Opisthophora	Lumbricidae	<i>Dendrobaena zicsi</i>	Rahovec, çakorr	Karaman 1973; Kerovec & Mrsic 1981; Sapkarev 1975; Lucija Seric Jelaska 2018	Nuk është vlerësuar	DD
Arhynchobdellida	Erpobdellidae	<i>Dina prokletijaca</i>	Bjeshkët e Nemuna	Grosser et al. 2016; Halil Ibrahimi, Astrit Bilalli 2018	Nuk është vlerësuar	DD
Mesostigmata	Zerconidae	<i>Zercon kosovina</i>	Bjelluhë, çakorr	Kontschan 2006; Lucija Seric Jelaska 2018	Nuk është vlerësuar	DD
Chordeumatida	Craspedosomatidae	<i>Dyocerasoma drimicum</i>	Drini i Bardhë	Mrsic 1985; Makarov et al. 2004; Lucija Seric Jelaska 2018	Nuk është vlerësuar	DD
Coleoptera	Staphylinidae	<i>Protamaurops serbicus</i>	Kaçanik	Karaman 1961; Gabor Mesaros 2018	Nuk është vlerësuar	DD

6. Përmbledhje

Rezultatet tregojnë se fauna endemike e Kosovës është e lidhur ngushtë me habitatet malore, ekosistemet ujore dhe zonat e ruajtura natyrore, të cilat paraqesin strehë të rëndësishme për mbijetesën dhe zhvillimin e shumë llojeve me shpërndarje të kufizuar. Veçanërisht lumenjtë, burimet ujore, liqenet, shpellat dhe pyjet malore kanë rëndësi të madhe ekologjike, pasi ofrojnë kushte specifike për një numër të konsiderueshëm organizmash endemikë.

Shumë prej këtyre llojeve janë të ndjeshme ndaj ndryshimeve antropogjene, përfshirë fragmentimin e habitatit, shpyllëzimin, ndotjen e ujërave, degradimin e ekosistemeve natyrore dhe ndikimet klimatike. Këta faktorë paraqesin kërcënime serioze për ruajtjen afatgjatë të biodiversitetit endemik dhe mund të ndikojnë drejtpërdrejt në zvogëlimin e popullatave të tyre.

Krahasuar me studimet e mëparshme, vërehet një përmirësim në dokumentimin e disa grupeve taksonomike, megjithatë ende ekzistojnë boshllëqe të konsiderueshme në të dhëna, veçanërisht për grupet invertebrore dhe organizmat e lidhur me habitatet ujore e nëntokësore. Kjo tregon nevojën për hulumtime të vazhdueshme shkencore, monitorim sistematik në terren dhe forcim të masave të konservimit, me qëllim të mbrojtjes së diversitetit biologjik dhe ruajtjes së vlerave unike natyrore të Kosovës.

7. Rekomandime

Këto lloje kanë një rëndësi të veçantë për shkencën dhe mjedisin, pasi nuk gjenden askund tjetër në botë. Shkatërrimi i habitateve të tyre nënkupton humbjen e tyre të pakthyeshme. Për këtë arsye, ruajtja e lumenjve, burimeve, shpellave dhe ekosistemeve të tjera natyrore është jetike për mbijetesën e këtyre specieve.

Megjithatë, shumë prej tyre janë të rrezikuara nga veprimtaritë njerëzore, si ndërtimi i hidrocentraleve, ndotja e ujërave dhe degradimi i habitateve natyrore. Prandaj, mbrojtja e këtyre llojeve unike është një përgjegjësi e rëndësishme për të siguruar ruajtjen e tyre për brezat e ardhshëm, andaj rekomandojmë të bëhet:

- Monitorimit i llojeve endemike;
- Përditësimi periodik i listave të llojeve;
- Rritja e zonave të mbrojtura dhe menaxhimi efektiv i tyre;
- Bashkëpunim më i ngushtë ndërinstytucional dhe akademik;
- Edukim dhe vetëdijësim publik mbi rëndësinë e biodiversitetit;
- Integrimi i të dhënave në politikat kombëtare të ruajtjes së natyrës.

9. Përfundim

Ky vlerësim preleminar tregon se Kosova posedon një diversitet të rëndësishëm të llojeve endemike, të cilat përfaqësojnë një trashëgimi të vlefshme biologjike. Ruajtja e tyre kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve shkencore, universiteteve dhe autoriteteve shtetërore.

Ky raport mund të shërbejë si bazë për studime të mëtejshme dhe për zhvillimin e strategjive kombëtare të konservimit.

10. Referenca

- *Libri i Kuq i Faunës së Kosovës;*
- *Udhëzimin Administrativ MEA – Nr.12/2020 për Llojet e Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura;*
- *Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233;*
- *Publikime shkencore relevante (të specifikuar sipas nevojës);*
- *Raporte institucionale mbi biodiversitetin;*
- *Raporti për Gjendjen e Natyrës 2018 – 2021;*
- *Pasqyrimi i Resurseve Natyrore sipas Rajoneve Zhvillimore – Fauna;*
- *www.faunaofkosovo.info;*
- *Konsultime shkencore me prof. Halil Ibrahimimi.*